

BAJRI DIBËR
Andur
Nr. 205 dt 01.03.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 847 Prot

Peshkopi, më 01/03 2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.19

Datë: 28.02.2024

“Marrëveshje për planin e veprimit për fazën e dytë të iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” 2024-2026”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Kelupja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 19 Datë 28/02/2024

“ Marrëveshje për planin e veprimit për fazën e dytë të iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” 2024-2026”

Mbështetur në ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’(I ndryshuar) neni 9, pika 1.6,shkronja ‘a’ dhe nenin 64, shkronjat ‘a’ dhe ‘gj’. Bazuar në marrëveshjen mes Bashkisë Dibër dhe UNICEF më Datë 22.12.2022 me nr prot.5876 dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.122 datë 22.12.2022; Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **28.02.2024**, me 19 vota pro, 1 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e iniciativës “Bashki Mike e Fëmijëve”2024-2026.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e rinisë,sporteve dhe higjenës,Bashkia Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **28.02.2024**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irina Shehu





847/1
04/03/24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.205/1 prot.

Peshkopi, më 04.03.2024

Lënda: Për vendimin nr.19, datë 28.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.19, datë 28.02.2024 "*Marrëveshje për planin e veprimit për fazën e dytë të iniciativës "Bashki mike e fëmijëve" 2024-2026*", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

P R E F E K T I

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E RINISË, SPORTEVE DHE HIGJENËS

PROJEKT - VENDIM

Nr. 01, Date 20/10/2024

Për miratimin e Projektit:

“Marrëveshje për planin e veprimit për fazën e dytë të iniciativës “Bashki Mike e Fëmijëve” 2024-2026”.

Në mbështetje të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (I ndryshuar) , neni 9, pika 1.6, shkronja “a” dhe nenin 64, shkronja “a” dhe “gj”. Bazuar në marrëveshjen mes Bashkisë Dibër dhe UNICEF më datë 22.12.2022 me nr prot. 5876 dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr 122 datë 22.12.2022.

Kërkojmë:

1. Miratimin e iniciativës “Bashki Mike e Fëmijëve” 2024-2026.
2. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e rinisë, sporteve dhe higjenës.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak dhe shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga ana e institucionit të prefektit të Qarkut Dibër.

Për Bashkinë Dibër:

Drejtorja e rinisë, sporteve dhe higjenës

Znj. ~~Denisa BASHA~~

Drejtorja Juridike

z. Ismeti SARAÇI


KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me autorizim

Zv. Kryetari i Bashkisë

Z. Ruzhdi DEDA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef
for every child

UNICEF-I NË SHQIPËRI

Nr. 5846 Prot

Dibër, më 22.12.2022

Nr. _____ Prot

Dibër, më 22.12.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BASHKISË SË DIBRËS

DHE UNICEF

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (referuar në vijim si “Marrëveshja”) zyrtarizon partneritetin dhe angazhimin e Bashkisë së Dibrës dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (“UNICEF”), për të përcaktuar mënyrat e bashkëpunimit në kuadër të Iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” në Shqipëri.

Midis:

Bashkisë së Dibrës, me adresë Bulevardi “Elez Isufi”, Peshkopi, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë, referuar në vijim si “Bashkia e Dibrës”


dhe

UNICEF, një organizatë ndër qeveritare, themeluar përmes Rezolutës 57 (I), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 11 dhjetor 1946, si një organ përfaqësues i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, me zyrë në Rruga “Skënderbej”, Ndërtesa e OKB-së, Kati i 3-të, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Dr. Roberto De Bernardi, referuar në vijim si “UNICEF”.

Bashkia e Dibrës dhe UNICEF-i, referuar në vijim si “Palë” më vete dhe “Palët” bashkërisht,


Duke marrë parasysh se:

- A. Bashkia e Dibrës është njësi e qeverisjes vendore, ngritur në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, e cila ndërmer, midis të tjerash, nisma për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve që janë pjesë e juridiksionit të saj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef 
for every child

UNICEF-i NË SHQIPËRI

- B. UNICEF, në përputhje me Kartën dhe Deklaratat e Misionit, punon me qeverinë, shoqërinë civile dhe organizata të tjera në mbarë botën për përparimin e të drejtave të fëmijëve udhëhequr nga Konventa e të Drejtave të Njeriut.
- C. Bashkia e Dibrës dhe UNICEF shprehin dëshirën për të bashkëpunuar në kuadër të Iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” sipas termave dhe kushteve të parashikuara me anë të kësaj Marrëveshjeje.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1

Qëllimi i Marrëveshjes


Marrëveshja synon vendosjen e bashkëpunimit institucional ndërmjet palëve me qëllim krijimin e mekanizmave për funksionimin e Iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” në Dibër. Përmes kësaj Marrëveshjeje, Palët shprehin angazhimin dhe përcaktojnë detyrimet e përbashkëta për ndërmarrjen e hapave dhe veprimtarive të nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

NENI 2

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në:

- i. nenin 9, pika 1.6, shkronja “a” dhe nenin 64, shkronjat “a” dhe “gj”, të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- ii. Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);
- iii. Marrëveshjen Bazë të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe UNICEF më 23 korrik 1993;
- iv. Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- v. Ligjin nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës”, Neni 46, pika a, b, c, ç, d.
- vi. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026





- vii. Programin e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, nënshkruar nga Qeveria Shqiptare dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara më 25 tetor 2021, për periudhën 2022-2026;
- viii. Dokumentin e Programit të UNICEF për Shqipërinë, miratuar nga Bordi Ekzekutiv i UNICEF-it në shtator 2021, për periudhën 2022-2026; dhe
- ix. Planin e Punës së UNICEF-it 2022-2023.

NENI 3


Objekti dhe Fusha e Veprimtarisë

- 3.1 Objekti i Marrëveshjes është përcaktimi i komponentëve të ndërveprimit të Palëve, në kuadër të zbatimit të iniciativës “Bashki mike e fëmijëve”. Kjo iniciativë synon të fuqizojë bashkitë, komunitetet ose njësitë administrative e qeverisjes vendore, në të cilat zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë përbërëse e politikave, programeve dhe vendimeve publike. Vizioni është që çdo fëmijë dhe i ri të shijojë fëmijërinë e tij/saj dhe të arrijë potencialin e plotë të zhvillimit.
- 3.2 Bashkia e Dibrës dhe UNICEF mund ta rinovojnë/ rishikojnë Marrëveshjen, në varësi të progresit të shënuar dhe sfidave të reja që mund të lindin gjatë bashkëpunimit midis Palëve.
- 3.3 Fusha e veprimtarisë së Marrëveshjes do të përfshijë të gjitha veprimtaritë dhe nismat e tjera që kanë lidhje me zbatimin e objektit të kësaj Marrëveshje.

NENI 4


Detvrimet e Palëve

- 4.1 Sipas Nenit 1, **Bashkia e Dibrës** do të:
 - i. Delegojë funksionet koordinuese të nismës “Bashki mike e fëmijëve” tek një personel në Bashki, i cili do të ketë përkrahje pune të rishikuar për të përfshirë përgjegjësitë e reja. Ky personel nuk duhet të jetë nga sektori i mbrojtjes së fëmijëve.
 - ii. Drejtojë dhe koordinojë me aktorë të ndryshëm (qeveritar dhe joqeveritar) ngritjen e strukturave mbikëqyrëse për nismën (komiteti drejtues i iniciativës).
 - iii. Krijojë forumin konsultativ të fëmijëve, si organ këshillimor pranë këshillit bashkiak. Përfaqësimi i fëmijëve në forum do të jetë nga të gjitha shkollat e bashkisë, në nivel qeverie nxënësish. Për këtë arsye një memorandum mirëkuptimi do të lidhet me






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef 
for every child

UNICEF-i NË SHQIPËRI

Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Dibër. Në partneritet edhe me organizatat e shoqërisë civile, do të organizohen 2 dëgjesa në këshill bashkiak me fëmijët në lidhje me buxhetimin për nevojat e tyre.

- iv. Koordinojë përpjekjet për mbledhjen e statistikave të fëmijëve; të kryejë dhe shpërndajë analizën e situatës së të drejtave të fëmijëve për Bashkinë Dibër, (me angazhimin e fëmijëve, prindërve dhe aktorëve të tjerë kryesorë vendorë).
 - v. Koordinojë hartimin e Planit të Veprimit (3 vjeçar), duke siguruar angazhimin e të gjithë aktorëve dhe të mundësojë mbulimin e sa më shumë aktiviteteve me buxhetin e nevojshëm. Ky proces do të mundësojë krijimin e një regjistri të nevojave për bashkëfinancime apo projekte në fushën e zhvillimit/realizimit të objektivave.
 - vi. Dorëzojë planin e veprimit dhe raportin vjetor të progresit në Këshillin Bashkiak për miratim.
 - vii. Koordinojë përpjekjet për monitorimin dhe raportimin vjetor të Planit të Veprimit, për të identifikuar arritjet, nevojat dhe sfidat e mundshme gjatë zbatimit.
 - viii. Promovojë iniciativën përmes platformave të ndryshme.
- 4.2 Sipas Nenit 1, UNICEF-i, në varësi të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion do të:
- i. Ofrojë mbështetje teknike për kryerjen e analizës së situatës së të drejtave të fëmijëve në Bashkinë Dibër.
 - ii. Ofrojë mbështetje teknike për hartimin e Planit të Veprimit (3 vjeçar), përcaktimin e prioriteteve, aktiviteteve dhe kornizës së rezultateve.
 - iii. Ofrojë mbështetje teknike për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të komitetit drejtues të nismës “Bashki mike e fëmijëve” dhe trajnimin e anëtarëve të komisionit, përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile.
 - iv. Ofrojë mbështetje teknike për ngritjen e forumit konsultativ të fëmijëve dhe trajnimin e tyre për të kontribuar në hartimin e Planit të Veprimit dhe monitorimin e tij. Si pjesë e trajnimeve do të jetë dhe fuqizimi i fëmijëve për ta përçuar zërin e tyre në degjesat me këshillin bashkiak gjatë buxhetimit.
 - v. Ofrojë mbështetje teknike në monitorimin dhe raportimin vjetor të zbatimit të Planit të Veprimit.
 - vi. Promovojë iniciativën përmes platformave të ndryshme.





- vii. Promovojë platformën U-Report, si një mundësi për fëmijët dhe adoleshëntët për të dhënë mendimin e tyre mbi çështjet që i shqetësojnë ata në komunitetet ku jetojnë.
- 4.3 Përveç listës së veprimeve të mësipërme, secila palë mund të kërkojë të shtojë përgjegjësi shtesë si pjesë e këtij bashkëpunimi. Në këtë rast, veprimet shtesë do të konfirmohen me shkrim ndërmjet palëve.

NENI 5


Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe Hyrja në Fuqi

- 5.1 Kjo Marrëveshje është e vlefshme deri më 30 Dhjetor 2025, përveç nëse zgjidhet përpara kësaj date nga Palët.
- 5.2 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët.

NENI 6

Pronësia Intelektuale

- 6.1 Në përputhje me rregullat, rregulloret, politikat dhe procedurat e UNICEF-it, të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e tjera pronësore, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar te materialet e shtypura ose të shkruara, materialet me pamje dhe zë, apo materialet e tjera, që përgatiten, mblidhen ose prodhohen si rezultat i ose gjatë zbatimit të Projektit, i përkasin UNICEF-it. Asnjë element në këtë Marrëveshje nuk jep asnjë të drejtë për pronësinë intelektuale mbi këto materialet. Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, UNICEF mund t'i japë leje me shkrim Bashkisë së Dibrës për t'i përdorur këto materialet, të cilat i nënshtrohen kushteve të përdorimit, siç përcaktohen nga UNICEF.
- 6.2 Secila prej Palëve merr përsipër ta përdorë logon dhe emblemën e Palës tjetër, sipas rastit, në lidhje vetëm me këtë Marrëveshje, përveçse kur merret leje paraprake për raste të veçanta nga njëra prej Palëve dhe Pala tjetër njoftohet me shkrim.
- 6.3 Të gjitha informacionet dhe materialet, duke përfshirë edhe informacionin e transmetuar dhe digjital që Bashkia e Dibrës synon t'ia ofrojë publikut apo palëve të treta, të cilat janë Pronë e UNICEF-it apo i referohen Marrëveshjes ("Materialet Promovuese") duhen rishikuar dhe miratuar me shkrim nga UNICEF-i përpara se të përdoren. Materialet që paraqiten për miratim duhet të jenë në përputhje me Paketën e Mjeteve të Brandit të UNICEF-it. Bashkia e Dibrës nuk mund ta ndryshojë pamjen ose paraqitjen e Pronave të UNICEF-it. Miratimi i UNICEF-it duhet të jepet brenda pesë (5) ditësh pune. Nëse nuk merret miratimi me shkrim i UNICEF-it, materiali konsiderohet i pamiratur. Bashkia e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef 
for every child

UNICEF-i NË SHQIPËRI

Dibrës mbulon të gjitha kostot e prodhimit dhe shpërndarjes së Materialeve Promovuese, përveç kostove të veta për asistencën në përgatitje, që mbulohen nga vetë UNICEF-i.

NENI 7

Të ndryshme

- 7.1 Kjo Marrëveshje përfshin të gjitha komunikimet e tjera midis Palëve lidhur me objektin e tij, qoftë me shkrim ose jo.
- 7.2 Çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje adresohen në përputhje me Planet e Veprimit ose korrespondencën e shkëmbyer midis Palëve.
- 7.3 Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje bëhet me shkrim dhe me marrëveshje midis Palëve.
- 7.4 Palët mund ta zgjidhin këtë Marrëveshje përmes njoftimit me shkrim vetëm nëse rrethanat çënojnë zbatimin me sukses të Planit të Veprimit, të përgatitur për këtë qëllim.
- 7.5 Palët zbatojnë të gjitha veprimtaritë dhe/ose ekspertizën e programuar apo të kërkuar në kuadrin e kësaj Marrëveshje, që janë në proces e sipër në momentin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje.
- 7.6 Të gjitha njoftimet, apo komunikimet në kuadrin e kësaj Marrëveshje, bëhen me shkrim dhe i dërgohen Palëve në adresat e mëposhtme:

UNICEF në Shqipëri

Personi i Kontaktit: Specialistja e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve dhe Vlerësimit


Zj. Elda Denaj, e-mail: edenaj@unicef.org

Bashkia e Dibrës

Drejtori i kabinetit të kryetarit


Denisa Basha, e-mail basha.deni@hotmail.com

- 7.7 Asnjë element i kësaj Marrëveshje ose lidhur me të nuk konsiderohet si heqje dorë, qoftë shprehimisht, apo në mënyrë të nënkuptuar, nga asnjë prej privilegjeve apo imuniteteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organeve të saj përfaqësuese, duke përfshirë edhe UNICEF-in, qoftë në kuadër të Konventës së OKB-së të Privilegjeve dhe Imuniteteve, apo të instrumenteve të tjera, dhe asnjë dispozitë e kësaj MM-je nuk interpretohet apo zbatohet në mospërputhje me këto privilegje dhe imunitete.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

unicef 
for every child

UNICEF-I NË SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barasvlershme në gjuhën angleze dhe shqipe, 2 (dy) kopje për secilën palë. Në rast mospërputhjes midis dy versioneve, mbizotëron ai në gjuhën angleze.

Për sa më sipër, Palët ekzekutojnë këtë Marrëveshje Mirëkuptimi.

Z. Rahim Spahiu

Dr. Roberto De Bernardi

Kryetar

Bashkia Diber



Përfaqësues

Fondi i Kombeve të Bashkuara për
Fëmijët

